

COVID 19. REFLEKTIME

Ateo XHAKO

VITI I 3-të, dega Administrim Biznes , UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPERISE



- 9 Marsi shenoi fillimin e dickaje te papare dhe te pa jetuar me pare per ne apo edhe prinderit tane. Qe ne fillimin e kesaj pandemie, frika dhe pasiguria per jeten mbizoteronte kudo. Ne Tiranen e zhurmshme dhe plot jete, heshtja u ul kembekryq dhe do vazhdoje te rrije ashtu edhe per pak kohe. Te gjithë po pyesnim njeri tjetrin, njerezit e dashur, shoket, miqte, se edhe sa kohe do vazhdonim keshtu, edhe sa kohe do kalonte per t'iu rikthyer jetes normale, edhe sa kohe do kalonte per te dhene nje puthje, nje perqafim, aq shume te munguar. Pyesnim dhe flinsim me njeri tjetrin se sa i keq ishte ky virus, se si na ndau per se gjalli me njerezit e zemres, se si mori dhe vazhdon te marre cdo dite qindra e mijera jete te pafajshme, se si vuri ne gjume edhe New York-un , qytetin qe nuk fle kurre, se si i gjithë globi ndali per shkak te tij.
- U perqendruam aq shume ne gjerat negative , saqe harruam te mirat qe vinin pas; harruam se ajri i Tiranës se ndotur nga mbipopullimi, dhe ajri i gjithë botes, eshte pastruar, harruam se flora dhe fauna, iu rikthyen jetes, ashtu sic ishte perpara babëzise se njerezve, harruam se Toka filloi te marre perseri fryme, sepse kishte qindra vite e helmuar dhe e sakatuar nga babëzia jone, nga ne , njerezit , qe kishim harruar se çdo te thote te jesh nje njeri me i mire, te jesh me i embel dhe me i dashur me njerezit, te kesh dhembshuri dhe te jesh i drejte.
- Ndoshta ky virus, erdhi si nje lajmetar i koheve moderne, per te na bere ne, qenieve te pabezitura te ketij planeti, te reflektojme; na ka dhene shansin te jemi pak me te mire se dje, me veten, dhe me njeri tjetrin. Kjo situatë do kaloje , ne te gjithë do ia dalim mbane, sepse keshtu bejme gjithmone. Por ne do ia kemi dale mbane vertete, nese pas gjithë kesaj, do jemi njerez me te mire, do jemi ata njerez qe do e bejme boten ku jetojme me te mire, dhe mbi te gjitha do jemi mirenjohes, per familjen, per miqte, per vete jeten.